

VENDIM
Nr. 386, datë 1.6.2022

PËR MIRATIMIN E FUSHAVE DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT, QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR DHE MBËSHTETJEN FINANCIARE TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER E TË STUDENTËVE, QË NDJEKIN KËTO PROGRAME NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

(ndryshuar me VKM-në nr. 397, datë 29.6.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë, përkatësisht, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, të studentëve shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë, që nuk janë njëkohësisht përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Studenti me notë mesatare në pranim, që:

i. ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00;

ii. në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00.

b) Studenti fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/t/disiplinën ku ka fituar çmimin;

c) *Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar.*

3. Mbështetjen financiare, vetëm për njërën nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, e përfiton studenti për program të parë studimi dhe që pranon:

a) të nënshkruajë marrëveshje, ndërmjet përfituesit të financimit apo përfaqësuesit ligjor të tij, institucionit të arsimit të lartë, ku pranohen për të kryer studimet, dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, për përfitimin e financimit në Republikën e Shqipërisë;

b) të punojë në profesionin për studimet e të cilit përfiton financim nga momenti që i lind e drejta për të punuar, bazuar në legjislacionin në fuqi, në sektorin shtetëror, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, për jo më pak se 3 (tre) vjet, përfshirë edhe rastin kur i ndërpritet financimi, për shkak të mospërmbushjes së kriterit të notës mesatare gjatë studimeve;

c) të kalojë zyrtarisht diplomën/at origjinale përkatëse të arsimit të lartë, për të cilin përfiton financim, nga institucioni publik i arsimit të lartë ku ka përfunduar studimet tek institucioni apo subjekti juridik ku punësohet, deri në shlyerjen e detyrimeve, sipas marrëveshjes së parashikuar në këtë vendim.

4. *Studenti përfitues sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, me qëllim vijimin e financimit, duhet të ruajë notën mesatare, jo më pak se 9.5 gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të ciklit të parë dhe të dytë ose gjatë ndjekjes së studimeve të integruara të ciklit të dytë në institucionin publik të arsimit të lartë.*

5. Studenti përfitues ka detyrimin për të kthyer masën e financimit të përfituar, në rast se:

a) përjashtohet nga institucioni publik i arsimit të lartë;

b) ndërpret studimet, për të cilat është mbështetur financiarisht, pa miratimin e institucionit publik të arsimit të lartë dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin;

c) nuk ka përfunduar studimet në ciklin përkatës brenda 1 (një) viti, pas përfundimit të kohëzgjatjes normale të studimeve, me përjashtim të rasteve të sëmundjeve, të rasteve të

fatkeqësive familjare apo kur parashikohet nga institucioni i arsimit të lartë, sipas përcaktimeve në marrëveshjen përkatëse të financimit.

6. *Përzgjedhja e studentëve përfitues sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, kryhet në bazë të renditjes, sipas notës mesatare/vendit të renditjes në olimpiada ndërkombëtare dhe fondit në dispozicion për vitin përkatës financiar.* Në rast të dhënies së donacioneve për këtë financim, në procedurën përzgjedhëse ka të drejtë të marrë pjesë edhe një përfaqësues i donatorit. Rregullat e hollësishme për afatet e aplikimit, shqyrtimit dhe procedurat për përcaktimin e masës dhe të mënyrës së financimit, për secilën nga kategoritë e parashikuara në këtë vendim, përcaktohen nga ministri përgjegjës për arsimin, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6/1. *Përzgjedhja e studentëve përfitues për programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, bëhet sipas kuotave të miratuara çdo vit për mbështetje financiare, për çdo LAL publike, nga ministri përgjegjës për arsimin dhe fondit në dispozicion për vitin përkatës financiar. Institucionet publike të arsimit të lartë i caktojnë këto kuota me vendim të Senatit Akademik për çdo program prioritar që ato ofrojnë, në përpjesëtim të drejtë me numrin e studentëve për çdo program dhe i përzgjedhin ato në bazë të renditjes, sipas notës mesatare në pranim, nëse numri i kërkuesve është më i madh se kuotat e ofruara. Vendimi i Senatit Akademik për shpërndarjen e kuotave për çdo program dhe për përzgjedhjen e studentëve përfitues i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.*

7. Studentët përfitues, sipas këtij vendimi, depozitojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin listën e notave dhe vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për vitin e parë dhe vijues të studimeve.

8. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas diplomimit deri në përmbushjen e detyrimit për punësim, përfituesit duhet të aplikojnë për çdo pozicion të lirë pune në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe institucionet e pavarura publike. Në institucionet, në të cilat marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, rekrutimi në pozicionet përkatëse i përfituesve kryhet me prioritet. Përfituesit, sipas këtij vendimi, punësohen nga Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, për gjithë kohëzgjatjen e detyrimit për punësim. Në rast mospunësimi deri në 6 (gjashtë) vite kalendarike nga dita e lindjes të së drejtës për punësim, studenti konsiderohet se i ka përmbushur detyrimet sipas këtij vendimi dhe ka të drejtën e tërheqjes së diplomës origjinale nga institucioni publik i arsimit të lartë ku ka përfunduar studimet e financuara, sipas këtij vendimi.

9. Studentët, të cilët kanë përfituar financim dhe nuk kanë realizuar detyrimet e programit përkatës dhe/ose i ndërpresin ato, sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim dhe në aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet përfituesit dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, duhet t'i kthejnë ministrisë përgjegjëse për arsimin shumën e përfituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e njoftimit nga ministria. Në rast të moskthimit të shumës apo refuzimit nga ana e përfituesit brenda këtij afati, ndiqen procedurat ligjore për zgjidhjen e çështjes, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Studentët përfitues, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, përjashtohen nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit dhe financohen në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, përgjatë kohëzgjatjes së vitit akademik, pas konfirmimit të frekuentimit të programit përkatës të studimit nga institucioni publik i arsimit të lartë.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

SHTOJCA NR. 1
(ndryshuar me VKM-në nr. 397, datë 29.6.2023)

Fushat e gjera të studimit	Fushat e detajuara të studimit	Programi i studimit
Arsimi	Arsimi	Arsim parashkollor
		Arsim fillor
Arte dhe humanizëm	Gjuhë dhe letërsi	Gjuhë shqipe dhe letërsi
	Histori dhe arkeologji	Histori-Gjeografi
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Biologji	Biologji
		Biologji-Kimi
	Biologji Shkencat e mjedisit	Studime mjedisore
		Shkenca mjedisore, profili: Menaxhim i burimeve natyrore
	Shkencat e mjedisit Kimi	Kimi
	Fizikë	Fizikë
	Matematikë	Matematikë
		Matematikë-Fizikë
	Matematikë-Elektronikë dhe automatizëm	Inxhinieri matematike
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	Elektronikë dhe automatizëm Teknologjia e mbrojtjes së mjedisit	Inxhinieri fizike
		Inxhinieri mjedisi
		Inxhinieri navale
	Mjete motorike, anije dhe avionë	Navigacion dhe menaxhim detar
	Mjete motorike, anije dhe avionë Miniera dhe industri nxjerrëse	Inxhinieri e burimeve minerare
		Inxhinieri e naftës dhe gazit
	Miniera dhe industri nxjerrëse Kultivim dhe prodhim	Inxhinieri gjeoinformatike
		Inxhinieri gjeologjike
		Inxhinieri gjeomjedis
		Inxhinieri agrare, profil: mbrojtje bimësh
		Inxhinieri agrare, profil: hortikulture
		Inxhinieri agrare, profil: agronomi
		Inxhinieri agrare, profil: agromekanizëm
		Zootekni dhe siguria e produkteve blegtorale
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari	Kultivim dhe prodhim Pyje	Biologji marine dhe akuakulturë
		Bioteknologji zooveterinare
		Agrobiologji
		Agrobiznes
		Agroushqim
		Vreshtari-Enologji
		Inxhinieri agronomike
		Inxhinieri pyjore
		Inxhinieri përpunim druri
		Mjekësi veterinare
	Pyje Veterinari	Menaxhim turizmi (rural, arkeologjik, kulturor, hotelieri-restorant, mikpritje)
	Turizëm	Ekonomi-Turizëm
Shërbime		Turizëm